



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.140/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugën publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë, i shqiptohet dënimi më gjatë në lartësi prej 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, me të cilën pretendon se me datën 04.06.2014, në ora 11.57 anëtarë të subjektit politik PDK, mbi rrugën publike “Zahir Pajaziti” në Podujevë, kanë vendosur banerë të kandidatit Agim Kuleta dhe Fadil Fazliu kandidat për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga ky subjekt politik. Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe e Kodit të Mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet.

Parashtresuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë, dhe i ka dhënë Urdhër për të Ndërmarr masat Përmirësuese lidhur me aneksen deri në datë 06.06.2014 në ora 10.00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se shtabi zgjedhor i PDK në Podujevë ka ndërmarr të gjitha masat përmirësuese me ç'rast me datën 05.06.2014 i ka larguar banerat për të cilët është parashtruar ankesa.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se **banerat** e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik PDK ishin vendosur mbi rrugën publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila dispozitë përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike* ”

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës së PZAP-it për përgjigje në ankesë dhe Urdhërit për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku kanë qenë të vendosur.

PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerat e kandidatëve të tij ishin të vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e

menjëhershme të subjektit politik PDK që ka ndërmarrë për evitim të shkeljes së dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të disa fotografive të cilat i ka ofruar si prova të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 140/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit

Xhevdet Abazi



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*